



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 31055/22
Kaçanik, 18.11.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **IX (nëntë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 22 nëntor 2022 (E martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi- OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Fatos Vishi –Këshilltar për Rini dhe Sport.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e IX-të (nëntë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, data 22 nëntor, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Sporti në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Ne saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

- 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete**

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka, A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit? Procesverbalit i mbledhjes së VIII-të (tetë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se VIII-të (tetë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2022, të datës 25.10.2022 / Lënda : 01Nr. 60/03-28474/22.

2.Sporti në komunën e Kaçanikut;

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: e hapi diskutimin për pikën: Sporti në komunën e Kaçanikut.

z.Fatos Vishi: Aktualisht në komunën e Kaçanikut veprojnë 13 klube aktive sportive, duke filluar nga Klubi Futbollit "Lepenci", Klubi Basketbollistik "Kaçaniku", Klubi Hendbollistik "Lepenci", Klubi i Futbollit të femrave "Bazeli 2015", Klubi i Volejbollit për femra "Kaçaniku", Klubi i Mundjes "Kaçaniku", Klubi Volejbollit Kaçaniku, Klubi Taekwondo "Kaçaniku" 2000, Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike-Kaçanik , Motokross "Kaçaniku", Shoqata Peshkatarëve Sportiv dhe Rekreativ, Shoqata Bjeshkatore Alpiniste "Kaçaniku 2015", Klubi Shahut "Lepenci Kaçanik", së fundmi është riaktivizua Klubi Basketbollistik "Lepenci".

Këto klube aktivitetin e tyre e zhvillojnë në palestrën e sportit të komunës Kaçanikut, me përjashtim klubi i Lepencit, aktivitetin e tyre zhvillojnë në stadiumin "Besnik Begunca". Kemi edhe disa shkolla futbolliste cilat veprojnë në komunën tonë, klubet tona garojnë në liga ndryshme të Kosovës, momentalisht si klub që është duke na krenuar është klubi i Mundjes, për shkak se kanë zhvilluar aktivitete Rumani , ku edhe kanë treguar rezultate duke e zënë vendin e dytë .

Znj. Arta Avdiu: Fillimisht dua të flas për një historik të shkurtër rreth sportit. Pas luftës në komunën e Kaçanikut, ekzistonin hiq më pak se 4 aktivitete futbollistike si: klubi futbollistik "Lepenci", "Kaçaniku", "Flamurtari" nga Glloboshica, dhe "Sharri" nga Hani i Elezit. Qe bënë gara në ligat e ndryshme të vendit deri në periudhën kur klubi futbollistik "Lepenci" na përfaqsonte në Superligë.

Në atë kohë kishim buxhet dhe menaxhim për ti mbajtur gjallë dhe aktive veprimtarin sportive të këtyre klubeve, ndërsa sot ka mbetur vetëm klubi futbollistik "Lepenci", i cili zhvillon gara në nivelin më të ulët të ligës së Kosovës. Njëashtu në atë periudhë vepronte edhe klubi hendbollit dhe klubi i basketbollit për femra, klube të cilat ndër vite janë shuar nga aktivitetet e tyre.

Riaktivizimi i klubeve të reja është më se i nevojshëm dhe obligativ, mbi të gjitha është obligim i drejtorisë përkatëse për ti mbështetur.

Problemi kryesor është financimi i këtyre klubeve, andaj drejtoria duhet të marrë parasysh se në çfarë përqindje duhet të bëj ndarjen e mjeteve, po ashtu të merr parasysh se në çfarë kategori bën garën ai klub dhe se çfarë niveli të suksesit arrijnë ai grup brenda vitit, dhe jo të ndajë mjete pa ndonjë kriter.

Në këtë takim shfrytëzoj rastin ti drejtohem drejtoreshës znj.Hafize, me pyetjet si ne vijim:

Ku kanë arritur punimet tek stadiumi, i cili po ndërtohet prej 6 (gjashtë) klm në largësi nga qendra dhe çka po bëhet aty? Sa është punuar që sa vite dhe cili është rezultati i gjithë atyre mjeteve të investuara në këtë drejtim?

Kush e ka dhënë iniciativën që ulëset në palestër të porositen me ngjyrat bardh e zi, ku te gjithë jemi në dijeni se ngjyrat tradicionale të ekipit te Kaçanikut janë kuq e zi?

z.Fatos Vishi: Sa i përket palestrës së sportit, kjo palestër ka qenë investim i Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të gjitha gjërat kanë qenë nën mbikëqyrjen e saj, andaj ne si komunë nuk kemi pas qasje në këtë drejtim pasi që edhe punimet dhe mbikëqyrja ka qenë investim i tyre dhe në kompetencat e tyre.

Çështja e ngjyrave të ulëseve, ka qenë dizajn i projektit nga Ministria, dhe ne si komunë nuk kemi mundur të bëjmë ndërhyrje, por në të ardhmen ne mundemi me i ngjyros dhe me ia përshtat klubeve tona, megjithatë sipas deklarimeve të tyre ata nuk kanë guxuar të devijojnë projektin se si ka qenë i paraparë për shkak të dizajnit që ata e kanë bërë më herët.

z.Betim Shala: Tek stadiumi, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, është duke investuar në fazën e parë, mirëpo si pasoje e ngritjes së nivelit të çmimeve, janë ndërprerë punimet.

Duke marrë parasysh që mjetet buxhetore janë të ndara nga Ministria, mirëpo procedurat e prokuroritit zhvillohen në kuadër të komunës së Kaçanikut, a mund të na njoftoni se çfarë ka vepruar komuna në zgjidhjen e këtij problemi, konkretisht çka ka ndërmarrë komuna që me u përfundua faza e parë dhe me fillu faza tjetër, apo a është inicuar ndonjë kërkesë në Ministri edhe për fazat e tjera, në mënyrë që të realizohen këto punime me kohë.

z.Fatos Vishi: Stadiumi është punuar dhe punohet me faza apo situacione, ku faza e parë është afërsisht në vlerë financiare prej 760,000.00 €.

Punimet janë ndërprerë nga kontraktori-kompania punëkryerëse, si pasojë e ngritjes së niveleve të çmimeve. Unë për aq sa jam në dijeni, kjo çështje është biseduar në Ministri dhe ministri kur ka qenë në vizitë në komunën e Kaçanikut. Kjo bisedë na është bërë ditur pikërisht prej kryetarit të komunës dhe drejtoreshës, është biseduar për pjesët e tjera që kanë mbetur edhe ngërçin që është krijuar, sipas tyre do të fillohet shumë shpejt me punimet, d.m.th fillohet ku ka ngec dhe pjesa tjetër me u përfundua.

Ne në muajin nëntor kemi adresuar kërkesat tona se çfarë kemi nevojë dhe në mesin e këtyre kërkesave është edhe përfundimi i stadiumit por edhe disa kërkesa tjera.

z.Arben Thaqi: Prioritetet për juve si Drejtori, a është masiviteti apo cilësia .

Ju si komunë cilën e konsideroni ma rendësi sportin apo rekreacionin dhe cilën moshë të atyre personave në ato klube sportive, keni në prioritet për subvencionime edhe për përkrahjen e faktorëve objektivë fushave dhe terrene sportive?

Ju jeni në dijeni që shkollat e futbollit, në asnjë aktivitet nuk janë subvencionu. Janë pesë apo gjashtë shkolla të cilat vazhdojnë aktivitetet e tyre sportive dhe asnjë vitë nuk janë subvencionu edhe pse ju si zyrtar për sport jeni në njohuri që shumica e tyre janë regjistrua si OJQ dhe kanë të drejtën e barabartë me të tjerët.

z.Fatos Vishi: Subvencionet në komunën tonë ndahen sipas një rregullore, e cila është rregullore e përgjithshme për gjitha komunat e Kosovës. Në atë rregullore specifikohen se si ndahen subvencionet për organizatat joqeveritare. Duke pasur parasysh se klubet sportive në komunën Kaçanikut veprojnë si organizata joqeveritare, ne duhet me ju përmbajte rregullores. Në atë rregullore nuk precizohen masiviteti, cilësia, sukseset. Në atë rregullore d.m.th. janë disa kriteret përgjithshme për OJQ, andaj komuna jonë këto subvencione i ndanë sipas kësaj rregullore. Në këtë rregullore marrin pjesë 5 (pesë) anëtarë, 3 (tre) anëtarë prej institucionit komunal dhe 2 (dy) anëtarë të jashtëm prej shoqërisë civile.

Ne jemi munduar që të ju dalim në ndihmë të gjitha klubeve sportive, për aq mundësin sa e kanë të lejuar. Sa i përket kushtet buxhetore, sigurisht që gjithë klubet sportive nuk mundën me qenë të kënaqur, gjë që i kuptojmë plotësisht, sepse një klub sportiv për të arritur suksese, duhet me pas subvencionime, buxhet dhe kushte të tjera por aktualisht gjendemi në këtë situatë.

Ndërsa sa i përket shkollave të futbollit, është e vërtetë se nuk janë ndihmuar megjithatë këtë vit, janë ndihmuar në aspektin e qasjes së tyre në objektet sportive që i posedon komuna jonë, të cilat janë në dispozicion të vazhdueshëm nga viti ardhshëm.

z.Ekrem Livoreka: Është shqetësues fakti se Klubi i Lepencit, lojën e parafundit e ka dorëzuar në tavolinë, konkretisht e ka bojkotua shkaku i mos pagesave.

Klubi "Lepenci", është klubi dhe krenaria e qytetit tonë, andaj ku është problemi tek klubi, a është kryesia apo mungesa e financave!

Unë propozoj që të gjithë qytetarët e Kaçanikut me u anëtarësua dhe me i dhënë minimum 1€ (një euro), në mënyrë që ta ringjallim klubin dhe mos të shuhet .

z.Fatos Vishi: Komuna jonë për këtë klub i ka ndare vlerë financiare prej 16,400.00 €, arsyet pse nuk e kanë realizuar lojën klubi, konsideroj që ato janë çështje të brendshme të klubit, ne si drejtori nuk kemi kompetenca me ndërhy në çështjet organizative të klubit. Pajtohemi plotësisht, me idenë për anëtarësim, por ato janë rregullore të brendshme që i rregullojnë brenda për brenda klubi, e jona është me i monitoru shumën e mjeteve 16,400.00€ , përpos klubit Lepencit dhe klubeve tjera në gjashtë mujorin e parë dhe në fund të vitit raportin përfundimtarë e raportojnë për subvencionet që i kanë përfituar, këtë raportim e bëjnë duke i dorëzuar raportet tjera në zyrat e pritjes mandej në atë raportim është një komision tjetër i posaçëm.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:50.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

